



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

Nr. 849 Prot.

Pogradec, më 24.02.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj. Kryetare,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim Projekt -Vendimin për:

**“ MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË
POGRADEC DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI ”**

Me respekt,

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 3 (tre)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 8 (tetë)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. ____ .Prot

Datë ____ . ____ 2026

PROJEKT- VENDIM

NR. ____ , DATË ____ . ____ .2026

PËR

**“MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË
POGRADEC DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI”**

Në mbështetje të; nenit 13, nenit 108, nenit 109, nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"; Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; shkronjës "ç" dhe shkronjës "dh" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neni 5 dhe neni 9 i Ligjit Nr. 35/2023 i ndryshuar "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve të institucioneve të administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"; Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"; i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 103, datë 11.02.2026 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", bazuar në dokumentacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

- 1.** Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrative dhe punonjësit e shërbimit të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative, Punonjësve të Policisë Bashkiake si dhe Ndërmarrjeve në varësi, sipas tabelave nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.** Efekte financiare do të fillojnë prej datës **1 Janar 2026**.
- 3.** Të gjitha vendimet e mëparshme të Këshillit të Bashkisë Pogradec, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, shfuqizohen dhe /ose anulohen.
- 4.** Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Pogradec, si dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.
- 5.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Pogradec, më 24.02.2026

RELACION

MBI PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË QËNDER, NDËRMARRJEVE NË VARËSI DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE

E nderuar Kryetare i Këshillit,

Të nderuar Këshilltarë,

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 328, date 31.05.2023 për “Klasifikimin e Funksioneve, Grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 103, datë 11.02.2026 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”

Projekt-vendimi që po ju paraqesim bazohet në Vendimin e mësipërm të Këshillit të Ministrave dhe është i domosdoshëm për të përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në gërmën ”ç” të nenit 54 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, ku shprehet se Këshilli i Bashkisë “ Miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi ”. Duke qëndruar tek ligjislacioni në fuqi, Bashkia Pogradec do të azhurnojë me ligjet dhe aktet nënligjore , zbatimin e ligjit për nivelin e pagave për Bashkinë Qendër, Njësitë e Vetëqeverisjes vendore dhe ndërmarrjet në varësi.

Sipas të dhënave të Gjëndjes Civile numri i banorëve të Regjistrit të Gjëndjes Civile për muajin janar 2026 është 91,922 banorë,

Bashkia Pogradec grupohet në kategorinë e Njësive të Qeverisjes Vendore me 50 001 -100 000 banorë, ku numri i banoreve përcakton kategorinë, klasat dhe nivelin e pagave për çdo pozicion pune.

Në lidhje me nivelin e pagave për punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj dhe në Njësitë Administrative për përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion i jemi referuar lidhjes nr. 5 të VKM-së 103, datë 11 Shkurt 2026.

- Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:
- 0.6 % pas çdo viti pune për 10 vjet vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8 % pas çdo viti pune për 10 vjet vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1 % pas çdo viti pune për 10 vjet vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, "vite pune", do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi apo në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së me pagesë papunësie,

Niveli i Kualifikimit:

- Niveli i kualifikimit sipas kornizes shqiptare të kualifikimeve është sipas lidhjes nr. 9 të VKM-se 503, datë 01.08.2024

Shtesa për kushte (natyrë të veçantë në punë):

- Sipas vkm-së 328 datë 31.05.2023, shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë në punë), 5 000 mijë (pesë mijë) lekë në muaj, për punonjësit e strukturave të TIK-ut, të bashkive deri në 100 000 banorë,
- Në lidhje me nivelin e pagave për Administratorët e Njesive Administrative me **50.001-100.000** banorë , jemi referuar lidhjes nr.8, të VKM nr. 103 datë 11.02.2026.
- Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës Publike", i jemi referuar VKM nr. 87 datë 06.02.2026 e cila zëvendësohet me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhën këtij Vendimi.

- Për punonjësit e shërbimit, Punëtorë (hidraulik, shofer, lulishtare, pompist, krasites) etj, kufiri i pagës bazë është **50 000 (Pesëdhjetë mijë)** lekë në muaj, sipas VKM nr.776 datë 19.12.2025,

Këta punonjës përveç pagës bazë, përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë.

Kjo shtesë aplikohet në masën 1 % mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë.

- Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme, por jo më shumë se 25vjet.

Në zbatim të VKM - së nr. 103, datë 11.02.2026 efektet financiare fillojnë nga data **01.01.2026**.



**NIVELI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË POGRADEC DHE
NDËRMARRJEVE NË VARËSI TË SAJ**



Tabela nr. 1 -

Niveli i pagës për funksionarët në Bashkinë e Pogradecit

EMËRTIMI	Paga	Kufiri Minimal dhe Maksimal lekë në muaj
Kryetar i Bashkisë	260,000	210,125-266,500
Zv/ Kryetar i Bashkisë	205,000	174,250 —210,125
Administrator Nj.A.Pogradec 20.001-50.000 banorë	110,000	82 000 –158,875
Administrator Nj.A.Buçimas 20.001-50.000 banorë	110,000	82 000 –158,875
Administrator Udënisht, Çerrave 5.001 – 20.000 banorë	110,000	66 625 -148 625
Administrator Nj.A. Proptisht, 5.001 – 20.000 banorë	105,000	66 625 -148 625
Administrator Nj. A Velçan, Trebinjë, Dardhas Deri në 5.000 banorë	105,000	66 625 -143 500

Tabela nr. 2 -

Niveli i pagës për nëpunësit civilë në Bashkinë Pogradec



KATEGORIA	KLASA	EMËRTESA E POZICIONIT	GR. DIPLOMËS	PAGA PËR POZICION	SHTESA PËR POZICION
1	2	3	4	5	6
I	I-IV	Sekretar i Përgjithshëm	1	97,375-184,500	180,000
II	II-2	Drejtor i Kabinetit, Sekretar i Këshillit Bashkiak	1	87,125-144,525	141,000
II	II-2	Drejtor Drejtorie,	1	87,125-144,525	141,000
III	III-2	Koordinator	1	71,750 -109,000	105,000
III	III-2	Këshilltar i Kryetarit,	1	71,750 -109,000	105,000
III	III-2	Përgjegjës Sektori	1	71,750 -109,000	90,000
III	III-3	Përgjegjës Sektori	1	66,625-102,000	80, 000
IV	IV-2	Specialist,	1ose 2 ose 3	46,125 -85,000	72,000
IV	IV-3	Specialist Koordinator vendor	1ose 2 ose 3	43,050-75,000	66,000
IV	IV-4	Specialist,Sekretari Kryetarit	1ose 2 ose 3	41,000 -65,000	58,000

Tabela nr. 3

Niveli i pagës për Punonjësit me kod pune dhe Punonjësit administrative të Bashkisë Pogradec

Nr.	Emërtesa e Pozicionit	Niveli Minimal/Maksimal/ Kod pune	Paga	Vjetërsia
1.	Përgjegjës Sektori	66,625-102,000	80, 000	1 %
2.	Inspektorë terreni	43,050-75,000	67, 000	1 %
3.	Kujdestar social,dhe punonjës të tjere	41,000 -65,000	60,000	1 %
4.	Koordinator lagje, Sekretariati KB	41,000 -65,000	60, 000	1 %
3.	Magaznier, Punonjës Administrativ	50, 000- 57, 000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	57, 000	1 %
4.	Punonjës shërbimi (Pastruese, shofer, roje)	50,000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50, 000	1 %

Tabela nr. 4**Niveli i pagës për Punonjësit e Qendres Komunitare**

Nr.	Emërtesa e Pozicionit	Niveli Minimal/Maksimal Kod pune	Paga	Vjetërsia
1.	Psikolog, Logopedist, Fizioterapist, Punonjës Social	41,000 -65,000	62, 000	1 %
2.	Koordinator për PAK, Kujdestar	41,000 -65,000	55, 000	1 %
3.	Punonjës Shërbimi	50,000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50, 000	1 %

Tabela nr. 5**Niveli i pagës për punonjësit e Njësive Administrative**

Nr.	Emërtesa e Pozicionit	Niveli Minimal/Maksimal	Paga	Vjetërsia
1.	Përgjegjës i Shërbimeve	41,000 -65,000	62, 000	1 %
2.	Punonjës Arkiv-protokoll, për NE, Koordinator për komunitetin dhe mbrojtjen e tokës	50,000-57,000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	57, 000	1 %
3.	Punonjës Shërbimi (Pastruese, Roje, Punëtor, shofer, elekticist, hidraulik)	50,000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50, 000	1 %

Tabela nr. 6**Niveli i pagës për administratën , Qendra Arsimore**

Kategoria	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	87,125 -144,525	141, 000
III	III-2	Përgjegjës Deges Ekonomike	1	71,750 -109,000	90, 000
III	III-3	Përgjegjës Çerdhe	1	66,625-102,000	80,000
IV	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	43,050-75,000	66, 000

Tabela nr. 7**Niveli i pagës për punonjësit mbështetës, Qendra Arsimore**

Nr.	Emërtesa e Pozicionit	Niveli Minimal/Maksimal	Paga	Vjetërsia
1	Kujdestare Çerdhe	50, 000-57, 000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	57, 000	1 %
2	Magaznier, Kuzhinier	50, 000- 57, 000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	53, 000	1 %
3	Ndihmës Kuzhinier	50, 000- 57, 000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	51, 000	1 %
4	Punonjës Shërbimi	50, 000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50, 000	1 %

Tabela nr. 8

Niveli i pagës për Administratën e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave & Punëve Publike

Kategoria	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	87,125 -144,525	141,000
III	III-2	Përgjegjës Sektori	1	71,750 -109,000	90,000
III	III-3	Përgjegjës sektori	1	66,625-102,000	80, 000
IV	IV-3	Specialist/ Ing, Jurist, Ekonomist	1 ose 2 ose 3	46,125 -85,000	66,000
IV	IV-4	Specialistë	1 ose 2 ose 3	41,000 -65,000	58,000

Tabela nr. 9

Niveli i pagës për punonjësit e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave & Punëve Publike

Nr.	Emërtesa e Pozicionit	Niveli Minimal/Maksimal	Paga	Vjetërsia
1.	Përgjegjës Sektori, mesëm	41,000 -65,000	58,000	1%
2.	Manovratorë I	43,050-75,000	75, 000	1%
3.	Manovratorë II	43,050-75,000	65,000	1%
4.	Shofer Kamionist, Brigadier	41,000 -65,000	58,000	1%
5.	Magaznier	50,000-57,000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	57,000	1%
6.	Teknik ndërtimi, shofer, elektrikist, hidraulik, saldator, marangoz, usta ndërtimi, bojaxhi, mekanik, dekori)	50,000-57,000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	54, 000	1%
7.	Punëtorë shërbimi (Punëtorë kanalizimi, roje, punëtorë varrezash, Pastruese)	50, 000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50, 000	1%



Tabela nr. 10

Niveli i pagës për Administratën e Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit

Kategori a	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	87,125 -144,525	141, 000
III	III-3	Përgjegjës Sektori	1	65,000 –98,000	80, 000
IV	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose3	46,125 -85,000	66, 000

Tabela nr. 11

Niveli i pagës për punonjësit Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit

Nr.	Emërtesa e Pozicionit	Niveli Minimal/Maksimal	Paga	Vjetërsia
1	Brigadier	50,000-57,000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	58, 000	1%
2	Magaznier	50, 000- 57, 000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	57, 000	1%
3	Punëtorë Specialiste, Hidraulik, Shofer, lulishtare, pompist, krasites)	50, 000- 57, 000 VKM nr.87 datë 06.02.2026	52, 000	1%
4.	Punëtorë shërbimi	50,000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50,000	1%

Tabela nr. 12

Niveli i pagës për Administratën e Agjencisë së Mbrojtjes së Territorit



Kategori a	Klasa	Emërtesa e Pozicionit	Gr. Diplomës	Paga për Pozicion	Shtesa për pozicion
II	II-2	Drejtor	1	87,125 -144,525	141,000
III	III-2	Kryeinspektor	1 ose 2 ose 3	71,750 -109,000	105,000
III	III-3	Përgjegjës sektori	1 ose 2 ose 3	66,625-102,000	80, 000
IV	IV-3	Specialistë	1 ose 2 ose 3	43,050-75 000	66,000
IV	IV-4	Specialistë	1 ose 2 ose 3	41,000-65,000	58,000

Tabela nr. 13

Niveli i pagës për punonjësit Agjencisë së Mbrojtjes së Territorit

Nr.	Emërtimi	Niveli Minimal/Maksim al	Paga	VJETËRSIA
1.	Përgjegjës sektori	43,050-75,000	75,000	1%
2.	Magaznier	50,000-57,000	53, 000	1%
3.	Inspektor i Policisë Bashkiake	43,050-75,000	72,000	1%
4.	Punonjës i Policisë Bashkiake	43,050-75,000	67, 000	1%
5.	Inspektorë ndërtimi	43,050-75,000	70, 000	1%

5.	Punonjës inspektimi, Mjedisi, Mbrojtjen e konsumatorit)	43,050-75,000	69, 000	1%
6.	Punonjës (Inspektor pyjesh)	41,000 -65,000	59,000	1%
7.	Punonjës shërbimi(për kujdesin e qeneve endacake)	50,000 VKM Nr. 776, datë 19.12.2025	50, 000	1%

Hartoi: Specialist Sektori Arsila Çina

Pranoi: Përgjegjës Sektori Sonalda Sllogu

Miratoi: Drejtor Laura Elmasllari

Konfirmoi: Drejtor Kabineti Alma Kanina

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**

